
KONTRATE

Referenca SH/Punime/2015/FZHR/P-26

E LIDHUR NDERMJET

Fondit Shqiptar të Zhvillimit

dhe

Operatorit ekonomik “Eral Construcion Company” sh.p.k.

Për objektin

“Ndërtim i urës në fshatin Skuraj, faza I, (ndërtimi i këmbëve të urës)”

Datë: 25.06.2015

Në Tiranë, sot me datë 25.06.2015, lidhet kjo Kontratë ndërmjet palëve:

Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Rruga "Sami Frashëri", Nr.10, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Benet Beci, Drejtor Ekzekutiv, (referuar me poshtë si "Autoriteti Kontraktor"
dhe

operatorit ekonomik "Eral Construcion Company" sh.p.k, Rruga e Kavajës, Pallati nr.29, Kulla B, Kati 9, Apartamenti 36, Tiranë, përfaqësuar nga Ervin Qëndro, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

1: Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja e punimeve të ndërtimit në objektin "Ndërtim i urës në fshatin Skuraj, faza I, (ndërtimi i këmbëve të urës)"

2. Vlera e Kontratës

Kontrat lidhet me një vlerë totale prej **2,761,610 (dy milion shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dhjetë) Lekë (pa TVSH)**, ose **3,313,932 (tre milion treqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) Lekë (me TVSH)**.

3. Afati i Kontratës

Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 2 (dy) muaj (nga data e lidhje së kontratës), sipas grafikut të punimeve bashkëlidhur, pjesë e kësaj kontrate.

4. Kjo Kontratë përbehet nga 5 Anekse

Janë pjesë përbërëse e kontratës

- a) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- b) Kushtet e Veçanta të Kontratës
- c) Aneksi 1 – Specifikimet teknike
- d) Aneksi 2 – Oferta e paraqitur në tender
- e) Aneksi 3 – Grafiku i punimeve
- f) Aneksi 4 – Sigurimi i kontratës
- g) Aneksi 5 – Projekti

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi



Ervin QËNDRO



I. Kushtet e përgjithshme të Kontratës

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk inohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik.
- 1.4 Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.5 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.6 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 "Çmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 "Data e fillimit" është përfshirë në të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit" do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.



- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtuues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Proçesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5:
Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6:
Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7:
Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.



Neni 8:
Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9:
Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10:
Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11:
Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12:
Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13:
Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14:
Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15:
Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16:
Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17:
Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18:
Disponimi i Kantierit

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.



Neni 19:
Raportimi i Grafikut të Zbatimit

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteve.

Neni 20:
Paralajmërimi në Kohë

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21:
Kontrolli i Cilësisë

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteve në zbatimin e kontratës.
- 21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22:
Defektet e Pakorrigjuara

- 22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23:
Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

- 23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:
- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24:
Përgjegjësitë e kontraktorit

- 24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25:
Sigurimi

- 25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit së Plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.
- 25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26:
Testimet dhe Inspektimet

- 26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.
- 26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspekte.
- 26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.
- 26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 26.5 As egzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.



Neni 27: Garancitë

- 27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

- 28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës

- 29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhen siç specifikohet në kontratë.
- 29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.
- 29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së egzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.
- 29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
- 29.5 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.

- 30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 31:
Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32:
Forca Madhore

- 32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- 32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33:
Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- 33.2 Autoriteti Kontraktor mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 33.3 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
- 33.4 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort



me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 34:

Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

- 34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35:

Negociatat dhe Amendamentet

- 35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.
- 35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.
- 35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36:

Ndryshimi i Porosisë

- 36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.
- 36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.
- 36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:
- Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - Korrigjime në materiale
 - Korrigjime në sasi

- 36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.
- 36.5 Ndryshimi i porosise nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37:
Preventivi për Njesi ose në Total

- 37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njësi. Nëse është një kontratë me çmim njësi, Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.
- 37.2 Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 38:
Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

- 38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapa të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.
- 38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.
- 38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39:
Ndërprerja për Mosplotësim

- 39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
- 39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.



Neni 40:
Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
- 40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41:
Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42:
Nënkontraktimi

- 42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
- 42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 42.3 Çdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë
- 42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 43:
Transferimi i të Drejtave

- 43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 44:
Sigurimi i Kontrates

- 44.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në

shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

- 44.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 44.3 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

**Neni 45:
Baza Ligjore**

- 45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 46:
Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

- 46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 46.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 47:
Përfaqsimi i Palëve**

- 47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

**Neni 48:
Lajmërimet**

- 48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetres sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.



Neni 49:
Llogaritja e Afateve

49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

II. KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- 1.2 Kontraktori është: **“Eral Konstruksion Company” sh.p.k.**

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej **331,393 (treqind e tridhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë tre) Lekë (10% të vlerës së ofertës)** duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: në fund të kontratës.

Neni 3: Drejtuksi i Projektit

- 3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: **Supervizori i caktuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- 3.2 Adresa/pika e kontaktit: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

Neni 4: Kantieri

- 4.1 Kantieri i Punëve do të jetë: **“Skuraj, Komuna Milot”**

Neni 5: Data e Fillimit

- 5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: **Jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës.**

Neni 6: Siguracioni

- 6.1 Nga data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:
 - a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: **100% e vlerës së Kontratës**
 - b. Për dëmtime ose humbje të paisjeve: **1,000,000 Lekë**
 - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: **1,000,000 Lekë**
 - d. Për dëmtime personale ose vdekje të personave në kantier: **500,000 Lekë**



**Neni 7:
Inspektimet dhe Testimet**

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: _____

Neni 8:

Lloji i Kontratës

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një: Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin ne Njësi.

**Neni 9:
Grafiku i Pagesës**

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm:

a. sipas situacioneve periodike të miratuara nga mbikqyrësi i punimeve, tek të cilat nuk likujdohet 5 % e vlerës totale të situacioneve si garanci e defekteve në ndërtim pas kolaudimit të punimeve.

b. Garancia e defekteve në ndërtim do të jetë 5 % e vlerës totale të kontraktuar (përfshi TVSH) dhe zgjat 2 vjet pas datës së kolaudimit përfundimitar.

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda 28 ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë Lek.

**Neni 10:
Pagesa Paraprake**

10.1 Kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Sherbimeve të Lidhura

**Neni 11:
Zbritja e garancisë së kontratës**

11.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshte

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Aneksi 1

Specifikimet Teknike



RELACION DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI : NDERTIM I URES NE FSHATIN SKURAJ.FAZA I (NDERTIMI I KEMBEVE TE URES DERI TEK SOLETA)

A- (PUNIMET E GERMIMIT)

- Ne zerat Nr.1 dhe 2 perfshihen te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me germimet per themelet e ballnave dhe te mureve anesore te ures.Thellesia Max e germimit per ballnat eshte deri ne 3,5 ml dhe per muret anesore deri ne 1.5 m.Duhet marre ne konsiderate qe punimet e germimit behen ne prezence te ujit
- Punimet e germimit do te kryhen me makineri te pershtatshme per te kryer kele proces.
- Dherat e dala nga germimi me perberje argjiloree suargjilore nuk do te perdoren ne asnje rast per mbushje .Ato do te largohen me makineri dhe do te hidhen ne nje vend te pershtatshem.
- Gjate germimit te respektohen te gjitha kushtet teknike te zbatimit te punimeve dhe te sigurimit teknik.

B- (MBUSHJET)

- Ne kete ze pune Nr.1 perfshihen te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me materialin (shavorr),transportin dhe hedhjen e tij ne objekt.
- Para fillimit te mbushjes behet ngjeshja e bazamentit ekzistues,duke e lageshtuar ate ne funksion te formacionit te tokes,stines dhe lageshtise natyrale.
 - Mbushjet do te behen me shtresa nga 15-20 cm dhe te ngjishen me mjete te pershtatshme,sic percaktohet ne kapitullin e shtresave.
 - Mbushjet mund te realizohen me cakull mbeturine,zhavor lumi natyral ose material tjeter shkembor te pershtatshem me trashesi 15-20 cm.

C- (MURET ANESORE DHE BALLNAT PREJ BETON)

Ne keto zera pune Nr. 1 deri Nr.4 perfshihen te gjitha shpenzimet e nevojeshme per realizimin e ketyre punimeve betoni duke perfshire bazen materiale betonin,transportin e tij,hedhjen dhe trajtimin e tij ne veper,ngjeshjen,lagjen etij,kalleper e derrases,vendosjen dhe dezarmimin e tyre.

- Muret dhe ballnat prej betoni jane parashikuar te vendosen ne bazament te qendrueshem te perbere nga formacione baze te qendrueshme. Ne rast kur formacioni i pershtatshem nuk del ne thellesine e percaktuar ne projekt, te germohet deri ne gjetjen e formacionit te pershtatshem.
- Formacioni i pershtatshem per bazament do te pranohet ai qe eshte percaktuar ne studimin gjeologo-inxhinierik bere per objektin perkates.
- Gjate vendosjes se kallepeve te percaktohen vendet e fugave te bymimit gjatesor qe do te jene ne cdo 4-8 m. Ndarja e fugave duhet te behet me lende druri me trashesi minimale 1 cm, cse material tjeter te pershtatshem qe do te aprovohet nga mbikqyersi i punimeve.
- Kallepi do te pergatitet per te arritur permasat e kerkuara te siperfaqes se strukturave dhe te jete i tille qe te qendroje drejt dhe te mos lejoje rrjedhje ose humbje gjate vendosjesse betonit.
- Gjate vendosjes se kallepeve , ne pozicionet e percaktuara ne projektin e mureve te vendosen kallepet e vrimave te kullimit. Ato do te behen me material te pershtatshem qe do te aprovohen nga mbikqyersi i punimeve.
- Gjate mbushjes me beton nuk duhet te kele deformime te formes. Per faqet e betonit , kur pjerresia e kalon nje te kalerten , duhen perdorur forma te larta.
- Kur ne betonin e jastekeve vendoset armature prej celiku , betonimi duhet te behet pasi te jete kontrolluar pergatitja dhe vendosja e saj ne kallep.

Betonimi behet me markat e betonit te percaktuara ne projekt, ne perputhje me kerkesat e kushteve teknike te zbatimit per keto lloji punimesh dhe standarteve shteterore ne fuqi.

- Minimum 7 ditë pas heqjes se kallepeve , do te behet mbushja mbas mureve me zhavor ose material tjeter shkembor te pershtatshem te miratuar nga mbikqyersi i punimeve.



Te pergiithshme

Betonimi do te vazhdoje pa nderprerje, me perjashtim te ndonje rasti urgjent (si thyerja e impiantit te perzierjes ose kohes se papershtatshme) qe betonimi do te nderpritet, fugat do te realizohen ne vendin e ndalimit ne menyre qe te mos demtoje qendrueshmerine, pamjen dhe funksionin e betonit.

FURNIZIM E VENDOSJE HEKUR S500

Ne kete cmim perfshihen shpenzimet qe kane te bejne me furnizimin, transportin dhe vendosjen e armatures se hekurit sipas vizatimeve te projektit.

-Celiku per armim te jete i markes S500.

-Celiku per armim i prodhuar do te permbush kerkesat dhe do te silltet ne kantier ose ne objekt ne gjendje te shtrire dhe jo te mbledhur.

-Provat e celikut do te behen ne perputhje me normat italiane CNR.

-Ne qofte se shufrat perputhen me kerkesat e CNR, kontraktori do te leshoje nje certifikate ku te konfirmoje qe mostrat e marre nga shufrat e levruara nga fabrika e kaluan testin.

Ing. Majlinda Kokaj

Ing. Ndrichim Allkaj

RELACION TEKNIK

Objekti qe kerkohet te ndertohet eshte nje ure ne Fshatin Skuraj te Komunes Milot, Qarku Lezhe mbi lumin Hurdhe. Kjo ure lidh banorët e fshatrave Skuraj, Gallatë, Malbardh, Lester, Gërnac, Vinjoll dhe Daul me Komunen Milot dhe pjesen tjeter te qendrave te banuara . Objekti do te ndertohet prej betoni te markes M 200 .

Duke ju referuar konkretisht lumit te Hurdhes verejme se ky lum qe nga ura e deri ne burimin e tij me te larget ka nje gjatesi rreth 11 km dhe nje disnivel rreth 400m ndermjet ures dhe pikes me te larte te burimit.kuota ne nivel absolut ku do ndertohet ura eshte 400 m.

Ne kete lume derdhen edhe rreth 45 ujembledhesa te tjere,te cilet e ushqejne vazhdimisht me uje dhe me nje prurje te konsiderueshme sidomos ne stinet me reshje te medha atmosferike.

Shpejtesia e rrjedhjes mesatare e keti lumi eshte rreth 1m/sek,por ne rastet e reshjeve te medha mund te arrije shifra mjaft te larta ne levizje.

Ne vendin e ndertimit te ures lumi ka nje seksion 14 m gjeresi si edhe rreth 3 m te larte.

Koha me reshje te medha atmosferike ka treguar se ky lume behet mjaft agresiv dhe me nje ardhje te menjehershme me nje prurje qe ka arrit edhe 100 m³ne sek.

Sheshi ku do ndertohet bazamenti i ures ka nje ndertim gjeologjik te perfaqesuar nga depozitimet kuaternare me nje trashesi te vogel me perberje nga nderthuerje alevrolito-ranore-konglomerate me trashesi te ndryshueshme ne shtrirje dhe ne renje.

Relievi paraqitet mesatar me renje dhe ngritje te forte ne sheshin e ndertimit te ures drejt jug perendimit, gje e cila mund te jete shkak edhe per ndonje rreshqitje te mundshme .

Depozitimet flishore kane nje trashesi te konsiderueshme. Themelet e objektit duhet te inkastrohen ne keto formacione baze.



Duhet patjeter qe gjate hapjes se gropes se themelit te jete nje specialist gjeolog pasi duhet te evidentohen ne vend formacionet perkatese gjeologjike dhe te behen ndryshimet e nevojshme n.q.s. verehen ndryshime formacionale.

Themelet dhe shpatullat e ures do te realizohen prej betoni te markes M 200.

Ne kete faze te pare do te kryhet vetem themelet dhe shpatullat anesore te ures.

Ing. Majlinda Kokaj

Ing. Ndriçim Allkaj

Shtresa Nr.1

Përbëhet aluvione dhe deluvione me ngjyre kafe ne gri, me shume lageshti, pak e ngjeshur. Trashesia e kesaj shtrese varion nga 0 m – 2.0 m.

Ka keto parametra fiziko – mekanike :

- ♣ Pesha volumore në gjendje natyrale..... $\Delta = 1.67 \text{ T/m}^3$
- ♣ Moduli i deformacionit..... $E = 75 \text{ kg/cm}^2$
- ♣ Këndi i fërkimit të brendshëm..... $\varphi = 18^\circ$
- ♣ Kohezioni..... $c = 0.2 \text{ kg/m}^2$
- ♣ Ngarkesa e lejuar në shtypje..... $\sigma = 1.1 \text{ kg /m}^2$.

Shtresa Nr. 2. Përbëhet nga formacioni flishor me ndertim alevrolito-ranore

Vetitë fiziko – mekanike të kësaj shtrese janë:

- ♣ Pesha volumore në gjendje natyrale..... $\Delta = 1.90 \text{ T/m}^3$
- ♣ Kohezioni..... $C = 0.30 \text{ kg/m}^2$
- ♣ Këndi i fërkimit të brendshëm..... $\varphi = 25$
- ♣ Moduli i deformacionit..... $E = 50 \text{ kg/cm}^2$
- ♣ Ngarkesa e lejuar në shtypje..... $\sigma = 1.5 \text{ kg/cm}^2$.

DUKURITE EKZOGJENE

Në kete grup përmbledhen fenomene te rëndësishme që ndikojnë direkt ne rrezikun gjeologjik të rajonit. Mbështetur dhe në klasifikimin e cituar më lart dukurite kryesore ekzogjene te takuara ne këtë rajon janë:

1. Tjetërsimi i shkëmbinjëve .
2. Erozioni shpator dhe lumor

1-Tjetërsimi i shkëmbinjëve .

Është mjaft i përhapur në të gjithë variantet e tij ,si ne ate fizik, fiziko-kimik dhe biologjik i shprehur me alterim të shkëmbinjëve. Më i pranishëm ky fenomen shfaqet në shkëmbinjë relativisht të butë (Melanzhi ,mollaset ,etj) por është shumë i qartë në formimet vulkanogjene e ato intruzive bazike e ultrabazike. Fenomi i tjetërsimit është i shprehur sidomos me koren e alterimit lateritik të shkëmbinjëve vulkanogjen pothuaj gjatë gjithë kontaktit te tyre me depozitimel kuaternare .

Fenomeni i tjetërsimit të shkëmbinjëve shprehet në rajon me çvendosje te masave të alternuara në drejtime të ndryshme sipas relievit.

2-Erozioni .

Veprimtaria shkatërruese e ujit (reshja atmosferike, rrjedhjet ujore) mund të jenë në formën e erozionit shpator dhe lumor. Rajoni duke qënë i tipit kodrinor malor i ka te zhvilluar të dy tipet në mase te konsiderueshme dhe jo të njëtrajshme.

Erozioni shpator.

Shprehet me gërryerjen e sipërfaqes së tokës, mbartjen dhe depozitimn e këtyre produkteve te shkatërrimit në kuota me të ulta nga ujrart e reshjeve atmosferike dhe vete pesha e tyre. Klima mesdhetare me rgjim të çrregullt te reshjeve ka rol të rëndësishëm në këtë fenomen.

Në mjaft sektorë fenomeni i erozionit shpator favorizohet nga mbulesa e varfer bimore por reshqitja ne fjale ka nje trashesi te konsideruashme dhe pjerrresi te relievit te forte pavaresisht mbulimit ndjeshem me bimesi dhe peme te larta .

Efektet shkatërruese të këtij erozioni janë te medha ndertuar kryesisht nga shkëmbinjë të butë apo të tjetërsuar. kështu kemi formimin e shumë levizjeve te masave te medha te tokes bujqesore, rrëkeve me disa decimetra thellësi ,përroskave si dhe thellimin dhe zgjerimin e përrenjëve duke krijuar vatra erozive dhe humbur sasi të mëdha toke bujqësore .

Dukurite endogjene gjeologjike

Shprehet me levizjet tektonike dhe neotektonike si pasoje e aktivitetit te vazhdueshem gjeologjik qe ndodh ne te gjithë rajonin te cilat ne disa raste cojne dhe ne shkaktimin e lekundjeve sizmike te



Kushtet gjeologo-inxhinierike.

Shkembijnjte dhe dherat qe ndertojne truallin ne kete rajon,sipas gjenezes.,veçorive petrografike te tyre ,natyres fizike dhe vetive fiziko-mekanike dhe ujure klasifikohen me nga 2 grupe:

I - SHKEMBINJTE.

1. Shkembijnjte e forte
2. Shkembijnjte mesatarisht te forte e te bute.

II - DHERAT .

1. Sedimente te shkrifet pa lidhje kohezionale .
2. Sedimente te shkrifet me lidhje kohezionale.

I - 1. Shkembijnjte e forte.

Shkembijnjte e forte karakterizohen nga qendrueshmeria e madhe ,deformimi i vogel,qendrueshmeria e madhe ndaj ujit dhe nga uji pershkueshmeria e larte.Keto lloje shkembore jane shume te pershatshme si bazamente per ndertimin e objekteve inxhinierike.Ato ne pergjithesi karakterizohen nga masa vellimore 2.6 gr/cm^3 ,ujithithje specifike te ulet,rezistence ne shtypje mbi 500 bar,modul elasticiteti mbi 10^5 bar,koefficient puasoni 0.1-0.2 ,fortesi mbi 8 dhe koefficient ferkimi shkemb-beton 0.6-0.7.

Nen veprimin e ngarkesave te jashteme statike apo dinamike shkembijnjte e forte sillen si trupa elastike,me shpejtesi te valeve sizmike mbi 400 m/sek.Ne rajonin e studimit ne grupin e shkembijnjeve te forte ,sipas zonimit litologjik perfshihen shkembijnjte karbonatike e ato vullkanogjen.

Nga pikpamja fizike jane shume koherente ,ne shpate formojne kanione me lartesi te madhe.Nen veprimin e tjetersimit kimik,te ujit,gelqeroret ne rajon jane shume te karstifikuar duke reflektuar forma te ndryshme karstike si guva,shpella ,hinka,etj me permasa te shumellojshme.Sikurse e kemi permendur edhe ne paragrafin e hidrogjeologjise shkembijnjte gelqerore formojne masive karstike me rezerva te fuqishme ujrash nentokesore prej te cileve dalin dhe burime me debite te larte .Gelqeroret karstike hyjne ne grupin e shkembijnjeve me pershkueshmeri te larte {ne inervalet karstike $K > 10^{-3}$ m/sek dhe ujethithje specifike te madhe mbi 100 l/min/ml}.

Shkembijnjte vullkano-sedimentar karakterizohen me parametra te larte mekanike dhe sjellje te mire gjeomekanike per bazamente dhe punime te tjera inxhinierike.

Qendrueshmeria e tyre ne shpate [ne llavat bazaltike} eshte e mire ,ndersa ne ndershtresat argjilo-selicore qendrueshmeria e tyre varet nga madhesia e kendit te renjes se shtresave me pjerresine e shpatit.

Vetite kryesore fiziko-mekanike dhe ujure te gelqeroreve te ketij tipi petrografik,nga te dhenat laboratorike te kryera ne zona te ndryshme te vendit rezultojne :masa specifike mbi 2.7 gr/cm^3 ,masa vellimore $2.5-2.6 \text{ gr/cm}^3$,poroziteti 1-5 %,koefficienti I filtrimit mbi 10^{-4} min/sek,ujethithja specifike {ne inervalet e çarjeve} 5-100 l/min/ml,rezistenca ne shtypje 1 boshtore $500-200 \text{ kg/cm}^2$,moduli i elasticitetit $10^5-10^6 \text{ kg/cm}^2$.



I-2.Shkembetje mesatarisht te forte e te bute.

Perfaqesohen nga nderthurje te argjilo-alevroliteve te rreshpezuara me popla e copra gelqerore ,silicore,vullkanitesh,

etj,me vendosje heterogjene ne prerje.

Shpesh ato kane ndertim kaotik.Qendrueshmeria e tyre varet kryesisht nga gjendja fizike ne te cilet ndodhet.Ne zonat e prishjeve tektonike ato kane qendrueshmeri te dobet duke formuar zona te lira rreshqitje .

II – 1. Sedimente te shkrifet pa lidhje kohezionale .

Rerat dhe zhavoret formohen kryesisht ne shtartin e lumit dhe te konuseve te derdhjes te perrenjeve malore,etj.Perberja petrografike e tyre varet kryesisht nga zonat shkembore qe ato shplajne .Konkretisht ne rajonin e studiuar perberesit e tyre jane kryesisht magmatike dhe karbonatike.

Ne to formohen shtresa ujembajtese poroze me perhapje ne te gjithë zallishten.Ato karakterizohen me uje pershkueshmeri te larte ($k > 10^3$ m/se).Ne grykederdhjet e perrenjeve perberja zhavorre eshte shume heterogjene.Ne pjesen e sipërme te konuseve,ne pergjithesi fraksioni poplor eshte mbi 50%,ndersa ne pjesen e poshteme te tij ai zbret e merr me teper karakter zhavoror te parrumbullakosor.Po ne kete drejtim verehet edhe rritja e fraksionit argjilorqe sherben si material mbushes I tyre qe arrin deri ne 20-30%.

II – 2 Sedimente te shkrifet me kohezion.

Ne kete grup hyjne suargjilat .Ne zonimin gjeoteknik te siperfaqe por prerja gjeologo-litologjike e tyre deri ne thellesine 6 m nga siperfaqja e tokes.Si te tilla ne rajonin e studiuar pavaresisht nga gjeneza suargjilat ndahen :

1.Suargjila me kollone te plote suargjilore.

2.Suargjila te perziera me depozitim copozor.

Suargjilat perfaqesohen nga grupi me i madh suargjilor me gjeneze aluvialo-deluviale .Ato jane me te lehta deri ne te renda me ose pa lageshti me konsistence nga e forte deri ne plastike.

Suargjilat jane heterogjene,me ngjeshmeri dhe plasticitet mesatare.Ne pergjithesi vetite kryesore fiziko-mekanike dhe ujqore te tyre jane :lageshtia 26-30 %,masa vellimore natyrale 1.85-1.95 gr/cm³,masa vellimore e skeletit 1.5-1.55,poroziteti 45-50 %,muduli i komprimimit 50-70 kg/cm²,kendi i ferkimit te brendshem 14-18°,kohezioni 0.1-0.3 kg/cm².

Kushtet gjeomorfologjike e morfometrike.

Tipet litologjike, veçorite morfometrike e morfoklimaterike, vetite gjeoteknike dhe faktore të tjere ekzogjen kanë kushtezuar tiparet kryesore të relievit. kështu në shkëmbinjtë argjilo-copezor terigjen të zonës relievit paraqitet i ngritur dhe me zhvillim të procesit të tjetërsimit. Në sektore periferike të tyre zhvillohen formime copezore koluviale ku relievi paraqitet pjesërisht i aksidentuar, i copëtuar nga proceset ekzogjene deri në natyrë bllokore. Formimet e flijshit shfaqin forma pozitive të relievit, me rënie relativisht të buta. Depozitimet eluvialo-deluviale kanë reliev me të sheshtë.

Zona karakterizohet nga një intensitet mesatar i copëzimit horizontal e vertical i kushtezuar prej ndertimit litologjike zhvillimit të tektonikës shkeputese. Tipi i relievit është i kombinuar erozionalo-denudues e karstik, me ndryshim të kështu të përsosur se shpatit, në distance të vogla.

Arteri kryesor ujembledhës është lumi Mat dhe Fand.

Nga pikpamja klimaterike përfaqëson një rajon pa zonalitet klimaterik, me klime relativisht të ngrohtë, ku temperatura zbret nën zero rralle herë gjatë gjithë dimrit.



NDERTIMI LITOLOGO FACIAL I PRERJES

Duke studiuar pjesen e sipërme të prerjes së zonës dallojme këto njësi litologjiko-faciale

Shtresa e parë : ndetohet nga një trashësi depozitimesh të kuaternarit të përbera nga suargjila, surera me trashësi të varjueshme nga 0-2.5m

Shtresa e dytë: ndetohet nga një trashësi e konsiderueshme depozitimesh sedimentare flishore

Ndërtimi gjeologjik.

Në ndërtimin gjeologjik të këtij pellgu ujëmbajtës dhe kryesisht të objektit në krahun e majtë të lumit Mat rreth 500m mbi Urën e Zogut me harqe marrin pjesë:

- Formacionet magmatike të zonës Mirdita.
- Formacionet karbonatike të zonës Mirdita.
- Formacioni flihor i nënzonës Krasta.
- Depozitimet kuaternare të ultësirës perendimore.

-**Formacioni magmatik i zonës Mirdita** është kryesisht ofiolitik jurasik dhe me pak vullkanogjeno-sedimentar. Në rajon afër kufirit të serisë me ultrabazikë takohen shkëmbenj metamorfik të përfaqësuar nga amfibolitet dhe rreshpe amfibolite. Midis formacionit ofiolitik mbizotërojnë shkëmbenjtë ultrabazikë të masivit Pilinardës-Rrëshenit(J_{2.3}) me shtrirje afërsisht meridionale VP-JL.

Mbi formacionin ultrabazik shtrihen amfibolitet kuarcore dhe rreshpet amfibolike me përhapje të kufizuar. Në tavanin e këtyre të fundit vendoset pakoja argjilite me copra e jurasikut të mesëm-kretakut të poshtëm(J₃-Cr₁). Formacioni vullkanogjeno-sedimentar që takohet në pjesët periferike të ofioliteve përbëhet nga ndërthurje rrymash llavore bazaltike me shkëmbenjtë silicor-radiolarite.

-**Formacioni karbonatik(T₃-J₁)**. Në rajonin e studiuar është e facies neritike. Kjo facie përhapet në të gjitha periferitë karbonatike perendimore dhe lindore të ofioliteve dhe përfaqësohet nga gëlqerorë biomitrikë masive që ndërthuren me gëlqerorë stromatolikë dhe me pak dolomitike.

-Formacioni karbonatik i kretakut të sipërm dhe eocenit të zonës Kruja. Ky formacion përfaqësohet nga gëlqerorë copëzorë dhe më pak gëlqerorë dolomitik(kretaku i sipërm).

-**Formacioni flihor i Mastriktianit-Paleogjenit(Cr₂^m-Pg₁₋₂)**. Ka përhapje të madhe në rajon dhe përfaqësohet nga ndërthurje të argjilave, alevroliteve, ranorëve dhe shtresa të rralla gëlqerorësh mergëlorë. Flishi është i tipit ritmik, tepër i rudhosur me mikrorudha të përmbysura.

-**Depozitimet kuaternare**. Kanë përhapje mbizotëruese në Ultësirën Perendimore dhe për rajonin tone nga Miloti në Patok për ujëmbledhësin e Matit duke përfshirë dhe luginat e lumit Fan nga ura e Rrëshenit deri në bashkimin me lumin e Matit dhe gjithë luginën e Matit nga grykë derdhja e përroit të Hordhuzit në këtë lum në afërsi të Shkopetit e deri në derdhjen në det.

Në bazë të kriterit stratigrafik janë veçuar këto njësi moshore:

-Plioceni i sipërm-Kuaternari i hershëm

-Pleistoceni

-Depozitimet e Pliocen-kuaternarit të hershëm nuk takohen në rajonin tonë.

Ndërsa depozitimet e Pleistoceni të cilat përfaqësohen nga depozitime aluviale që ndërtojnë pjesën akumulative të taracave në lumin e Fanit në zonën poshtë urës së Rrëshenit dhe përfaqësohen nga konglomerate me zaje mesëm dhe zaje mëdhenj me çimentim të dobët dhe me përzierje argjilash të kuqërremta. Këto depozitime janë të përhapura edhe poshtë depozitimeve të Holocenit në fushën e milotit të përfaqësuar nga aluvionet me morfologji në formë freskorje(bare në formë freskorje) me trashësi që arrijnë deri 300m(gryka e lumit Mat) dhe futen disa kilometra në drejtim të detit Adriatik. Këto aluvione përbëjnë rezervuarët ujor më të fuqishëm të zonës.

- Depozitimet e Holocenit të përfaqësuar kryesisht nga tipi aluvial, mbulon fushën e bregut të Mates dhe Milotit. Këto depozitime kanë trashësi nga disa metra në 20-30m duke u vendosur



po mbi depozitime aluviale të Pleistocenit. Këto depozitime shpesh ndërthuren me depozitime kënetore.

- Depozitimet proluviale të sotme (Q_4^{pl}). Këto depozitime përhapen rrëzë shpateve dhe në grykëderdhjet e përrenjëve e prroskave.

2.6 Neotektonika.

Në bazë të rajonizimit neotektonik zona në studim përfshihet në Ultësirën perendimore të Trevës së jashtme me regjim në shtypje horizontale, pra me prirje të përgjithëshme ngritëse, por me lëvizje diferenciale intensive gjë që tregon se ka sektorë të vijës bregdetare që zhvendoset në perendim, por ka dhe sektor që zhyten pra me vijë bregore që përparon drejt kontinentit siç ndodh në vijën bregore të Tales pra poshtë sektorit tonë. Kjo bënë që pozicionet e shtretërve të lumenjëve të ndryshojnë dhe sidomos në grykë derdhjet e tyre.

Edhe gjatë kuaternarit të sotëm lëvizjet e reja tektonike kanë vazhduar dhe vazhdojnë edhe sot të shkaktuara nga stili i përgjithshëm diferencues i sektorëve ulës-ngritës gjë që ka sjellë formim të madh sedimentesh aluviale të lumenjëve. Si rezultat i ndërhyrjeve të aktivitetit njerëzor për të zotëruar natyrën dhe për të nxjerrë përfitime materiale prej saj kanë ndodhur dhe ndryshime në shtretërit e lumenjëve.

Raporti hidrogeologjik

Veçoritë hidrogeologjike të njësive litostrtigrafike.

Mbeshtetur në përshkrimin gjeologjik të zonës rrjedh se sipërfaqja me e madhe mbulohet nga formimet magmatike (ultrabazike dhe efuzive të J_2), formimet flishore $Cr_2^m - Pg_{1.2}$ gëlqerorët dhe nga formime kuaternare Q_4 .

a. **Formimet magmatike** që marrin pjesë në rajon dhe përfaqësohen nga intruzive dhe efuzive në përgjithësi janë të papërshkueshëm dhe në këtë aspekt nuk përfaqësojnë kolektor ujëmbajtës. Vetë ndërtimi litologjik shpreh qartë pamundësinë e transportit të ujrave nëntokësor pasi ndërtohen nga shkëmbenj jo me shume çarje, pra janë kompakt. Ka raste që aty ku kemi çarje dhe prishje tektonike mund të mendohet që mund të takohen ujra nëntokësor. Këto janë të vendosura poshtë depozitimeve aluviale të lumit Fan dhe Mat.

b. **Formimet flishore** që marrin pjesë në rajon janë shkëmbenj të papërshkueshëm dhe në këtë aspekt nuk përfaqësojnë kolektor ujëmbajtës. Vetë ndërtimi litologjik, alternimet argjilo – alevrolito – ranorike shprehin qartë pamundësinë e transportit të ujrave nëntokësor. Për këtë arsye ato janë shkëmbenj ekranizues të ujrave, pra kanë aftësi mbajtëse por jo qarkulluese për shkak të mungësës së çarjeve e porozitetit. Të gjithë këta shkëmbenj kanë përshkueshmeri shumë të ulët dhe për pasojë edhe ujëmbajtja paraqitet në këto nivele.

Burimet natyrore në sektorin e përhapjes së tyre kanë prurje më të vogël se 0.11/sek. Nuk përjashtohet mundësia që në sektorët ku prerja litologjike përfaqësohet nga ndërshtresa gëlqerorësh e konglomeratësh të gjenden sasira pak a shumë të rëndësishme ujrash nëntokësore, apo sipas linjave tektonike që kanë komunikim hidraulik me shtresat ujëmbajtëse. Për secilin rast rajonizimi hidrogeologjik dhe klasifikimet përkatëse janë bërë duke dhënë dhe shkallën e ujëmbajtjes.

Si përfundim këto formime paraqiten me parametra hidrogeologjik negativ. Ndër to veçojmë ujëpërshkueshmërinë, koeficientin e filtrimit, ujëdhënien etj që variojnë rreth vlerave që i klasifikojnë këta shkëmbenj si të rëndësishëm në aspektin hidrogeologjik. Këto depozitime janë të vendosura poshtë depozitimeve aluviale të lumit Mat dhe përbëjnë tabanin (dyshtemenë e këtyre aluvioneve).

c. **Depozitimet karbonatike.** Në këta shkëmbenj janë të zhvilluar në shkallë të lartë dukuritë karstike. Prej tyre mund të veçojmë gëlqerorët me ndërtim shtresor e masiv të kretakut të sipërm dhe shumë më pak ato të triasikut. Brenda tyre zhvillohen trajta karstike si hinka, shpella, puse gëzhime etj. Nga pikpamja hidrogeologjike ato kanë veçori të rëndësishme: Infiltrimi dobishëm ka vlera të larta herë herë të përafërta me bilancin ujqor. Përshkueshmëria e shkëmbenjëve karbonatik është në përgjithësi e lartë, por jo e njëtrajtëshme. Rreth zonës që është marrë në shfrytëzim pra të pjesës së lumit Mat këto shkëmbenj kanë përhapje jo shumë të madhe, dhe si rrjedhim në aspektin hidrogeologjik nuk gëzojnë të gjitha vetitë hidrogeologjike për t'i



klasifikuar në shkëmbenj me rezerva të larta ujore. Kjo është e kushtëzuar nga vëllimi i vogël që përfaqësojnë ato në natyrë d.m.th. shkalla e përhapjes dhe karakteri bllokor dhe gravitativ.

Nga eksperiencia e punimeve dhe e studimeve hidrogeologjike të kryera në zona analoge me këta shkëmbenj rezulton se ato përmbajnë ujra të ëmbëla të ftohta, mbetje e thatë 0.3 – 0.5gr/l dhe fortësi 10 - 15⁰ gjermane me mbizotërim të joneve hidrokarbonate e kalciumore në përbërjen kimike.

d. Depozitimet e kuaternarit të sotëm. Ato përfaqësohen nga aluvionet, deluvionet dhe formimet e shkriфта të përziara deluviale – koluviale – proluviale. Çdo njëri nga këto tipe gjenetike karakterizohet me veti të ndryshme hidrogeologjike. Aluvionet ndërtojnë zallishten dhe shtratin e lumit Mat së bashku me fushën aluviale që shfrytëzohet nga lavatriçet e vendosura në këtë lum. Përfaqësohen nga zhavore si dhe alterime shtresash argjilore e suargjilore. Coprat apo zajet janë të madhësive e përmasave të ndryshme të rrjedhura kryesisht nga shkëmbenj magmatik. Në luginën e lumit ato janë të zbuluara dhe jashtë shtratit dhe mbulohen nga formimet kokërrimta subargjilore – argjilore.

Depozitimet zhavorore të lumit Mat përmbajnë ujra nëntokësore me rezerva deri diku të mëdha dhe me cilësi të mirë kimike. Karakterizohen me mineralizim të vogël nga 0.5 – 1gr/l, fortësi të përgjithëshme 20⁰ gjermane dhe janë të tipit hidrokarbonat kalciumore e magneziumore. Formimet kanë veti të larta filtruese dhe kanë prodhimtari ujore. Niveli i ujrave freatike në zonën e shfrytëzimit është afër sipërfaqes.

Nga studimet e kryera në basenin e lumit Mat ku një degë e tij vjen edhe nga lumi Fan rezulton se vlera mesatare e koeficientit të filtrimit është 100 – 200m/ditë, ujëpërcjellshmëria 2000 – 40000 m²/ditë etj.

Edhe në formimet e përziara deluviale – koluviale – proluviale që ndërtojnë luginën e projit përrenjëve malor dhe prroskat që derdhen në lumin Mat përmbajnë ujra nëntokësor që qarkullojnë ndërmjet depozitimeve që ndërtojnë zonën. Furnizimi i tyre bëhet nga ujra të reshjeve si dhe atyre që drenojnë nga faqet e luginës.

THEKSOJME SE:

Duke ju referuar konkretisht lumit të Hurdhes vërejmë se ky lume që nga ura e deri në burimin e tij me të largët ka një gjatësi rreth 11 km dhe një disnivel rreth 400m ndërmjet ures dhe pikës me të lartë të burimit. Kuota në nivel absolut ku do ndërtohet ura është 400 m.

Në këtë lume derdhen edhe rreth 45 ujembledhesa të tjera, të cilat e ushqejnë vazhdimisht me ujë dhe me një prurje të konsiderueshme sidomos në stinët me reshje të mëdha atmosferike.

Shpejtësia e rrjedhjes mesatare e këtij lumi është rreth 1m/sek, por në rastet e reshjeve të mëdha mund të arrijë shifra mjaft të larta në levizje.

Në vendin e ndërtimit të ures lumi ka një seksion rreth 12m të gjërë si edhe rreth 3m të lartë.

Koha me reshje të mëdha atmosferike ka treguar se ky lume bëhet mjaft agresiv dhe me një ardhje të menjehershme me një prurje që ka arritë edhe 100 m³ në sek.

SIZMICITETI I ZONES

Zona e kurbinit perfshihet nga nje intensitet sizmik prej 7-8 balesh. Ky intensitet I larte sizmik lidhet me zhvillimin neotektonik te zones dhe ndertimin formacional te saj. Kriteret gjeologjike vleresuese per sizmicitetin zbulojne per zonen Lezhe-Rreshen vatra me magnitude 5.5-5.9, qe perfaqeson nje nyje tektonike teper aktive gjate pliocen-kuaternarit dhe shoqerohet me nje gradient te madh te levizjeve te reja vertikale. Gjate termeteve depozitimet e shkrufta rrisin intensitetin e termeteve me 1 e me shume balle.

Analiza mbi termetin e prillit 1979 tregon influencen kushteve gjeologo-inxhinierike, hidrogjologjike, morfologjike etj ne rritjen apo uljen e intensitetit te termeteve.. Vete deluvionet qe ndertojne shpatin e zones perbejne nje rrezik me shume ne rastet e nje lekundjeje sizmike pasi relievi eshte i forte dhe deluvionet kane nje lidhe kohezionale te dobet.




REKOMANDIME

1-Sheshi ku do ndertohet bazamenti I ures ka nje ndertim gjeologjik te perfaqesuar nga depozitimet kuaternare me nje trashesi te vogel me perberje nga nderthuerje alevrolito-ranore-konglomerate me trashesi te ndryshueshme ne shtrirje dhe ne renje


2-Relievi paraqitet mesatar me renje dhe ngritje te forte ne sheshin e ndertimit te ures drejt jug perendimit, gje e cila mund te jete shkak edhe per ndonje rreshqitje te mundshme

3-Depozitimet flishore kane nje trashesi te konsiderueshme. Themelet e objektit duhet te inkastrohen ne keto formacione baze.

4-Duhet patjeter qe gjate hapjes se gropes se themelit te jete nje specialist gjeolog pasi duhet te evidentohen ne vend formacionet perkatese gjeologjike dhe te behen ndryshimet e nevojshme nqs verehen ndryshime formacionale



RELIEVI I KUOTUAR NE SKURAJ
SH. 1:2500



PUNOI: Ing. Bardhok BARDHI



Oferta e paraqitur në Tender



[22/05/2015]

FORMULARI I DEKLARIMIT TË OFERTËS

Emri i Ofertuesit: [Eral Construction Company]

Për: [Fondi Shqiptar I Zhvillimit]

Procedura e prokurimit: [Procedura e Hapur-Pune]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Ndërtim i urës në fshatin Skuraj, faza I, ndërtim i këmbëve të urës]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletin i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke lu referuar procedurës së lartpërmendur, ne të nënshkruarit, deklarojmë se:

- Çmimi total i ofertës sonë është [2.761.610 dy milione e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dhjetë] Leke pa TVSH;
- Çmimi total i ofertës sonë është [3.313.932 tre milione e treqind e trembedhjetë mijë e nentëqind e tridhjetë e dy] Leke me TVSH

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|-----------------------|--|-------|-------------|------------------|
| Nr | Përshkrimi i Puneve | Sasia | Çmimi Njësi | Çmimi Total |
| 1 | Ndërtim i urës në fshatin Skuraj, faza I, ndërtimi i këmbëve të urës | 1 | 2.761.610 | 2.761.610 |
| Shuma | | | | 2.716.610 |
| TVSH (20 %) | | | | 552.322 |
| Totali me TVSH | | | | 3.313.932 |

Përfaqësues i ofertuesit
"Eral Construction Company" shpk
Ervin Qendro



Ofertes : "Eral Construction Company" Shpk
 Nipi K 82230002 K

PREVENTIV

OBJEKTI: NDERTIMI I URES NE FSHATIN SKURAJ. FAZA I (NDERTIMI I KEMBEVE TE URES DERI TEK SOLETA)

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Çmimi(leke) | Vlera(Leke) |
|---|---------|--|----------------|-------|-------------|------------------|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 5 | 7 |
| I. PUNIME GERMIMI DHE MBUSHJE NE URA | | | | | | |
| 1 | | Germim dheu per ballnat anesore h=3.5 m | m ³ | 180 | 250 | 45.000 |
| 2 | | Germim dheu muret mbajtes h<1.5 m | m ³ | 85 | 250 | 21.250 |
| Shuma I | | | | | | 66.250 |
| II. PUNIME BETONE DHE B/ARME NE URA | | | | | | |
| 1 | | Beton M-200 per themelet e ballnave anesore | m ³ | 108 | 8000 | 864.000 |
| 2 | | Beton M-200 per themelet e ballnave anesore + kallep | m ² | 39 | 8000 | 312.000 |
| 3 | | Beton M-200 per muret mbajtes + kallep | m ² | 118.3 | 8000 | 946.400 |
| 4 | | Beton M-300 per jasteket b/arme + kallep | m ³ | 5 | 10000 | 50.000 |
| 5 | | F. V. hekur S500 (sipas preventivit 0,6 ton) (e sakta 4,083) ton | ton | 4,083 | 120.000 | 489.960 |
| Shuma II | | | | | | 2.662.360 |
| III. PUNIME MBUSHJE NE RRUGE | | | | | | |
| 1 | | Mbushje dhe ngjeshje me zhavor | m ² | 220 | 150 | 33.000 |
| Shuma III | | | | | | 33.000 |
| Shuma(I+II+III) | | | | | | 2.761.610 |
| TVSH 20 % | | | 20% | | | 552.322 |
| Shuma Totale me TVSH | | | | | | 3.313.932 |

Per "Eral Construction Company" Sh.p.k

Administratof
 Ervin Qendro







GRAFIK PUNIMESH

Objekti: "NDERTIMI I URES NE FSHATIN SKURAJ, MILOT FAZA PARE

| Emertimi punimeve | Muaji 1 | | | | Muaji 2 | | | |
|------------------------------------|---------|---|---|---|---------|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 |
| PUNIME GERMIMI DHE MBUSHJE NE URA | | | | | | | | |
| PUNIME BETONI DHE B/ARME NE URA | | | | | | | | |
| PUNIME GERMIMI DHEMBUSHJE NE RRUGE | | | | | | | | |


ING. Majlinda KOKAJ

ING. Ndricim ALLKAJ

ING. NDRICIM ZBATIM
ING. N. ALLKA
NR. 219.6-0853/2



Sigurimi i Kontratës



Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 5 Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355 4 238999 / 238899 Fax: 00355 4 223841 Cel: 00355 66 20 70 659 E -mail: info@eurosig.al www.eurosig.al
Nipt-i : K41926801W

Seria 0015801

FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES

Ref. _____

Data 18/06/2015

Për: Fondi Shqiptar i Zhvillimit,

(Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor)

Në emër të: Eral Construction Company Shpk. TIRANE

Nipt-i

K82230002K

(Emri dhe adresa e ofertesit të siguruar)

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): procedurë e hapur

(Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor)

Përshkrimi i shkurtër i kontrates Ndërtim i urës në fshatin Skuraj, faza I ndërtimi i këmbëve të

(Lloji procedures dhe objekti)

urës

Publikimi(nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr _____, date _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmëndur, dhe me kusht që Eral Construction Company Shpk

(emri i ofertesit të përcaktuar fitues)

t'i jetë akorduar kontrata, ne vertetojmë se Eral Construction Company Shpk

ka derdhur

(emri i ofertesit të përcaktuar fitues)

një depozitë pranë Shoqërisë Sigurimeve "EUROSIG" sh.a., në një shumë prej:

Lekë 331,392.00 (treqind e tridhjetë e njëmijë e treqind e nentëdhjetë e)

(shuma me fjale)

dy

si kusht për garantimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

(Emri autoritetit kontraktor)

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Fondi Shqiptar i Zhvillimit

(Emri autoritetit kontraktor)

Vlerën e siguruar, brënda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmëndë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës DY MUAJ

Lëshuar në TIRANE , më 18/06/2015 20 .



SHOQERIA E SIGURIMEVE "EUROSIG" sh.a

Përfaqësuesi _____

(Emri, mbiemri, firma, vula)



Projekti

